



Pranuar me dt.	30.11.2023	Pranuar me dt.	24.11.2023
Orga	Num	Nr.Ekzempl.	Vlera
	27181		387

UNIVERSITETI - UNIVERSITY

"ISA BOLETINI"
MITROVICË

Fakulteti i Edukimit

KËSHILLI I FAKULTETIT TË EDUKIMIT, në mbështetje të nenit 72 dhe nenit 166 të Statutit të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, në bazë të nenit 9 të Rregullores së UIBM për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm, me nr. prot. 1670 të dt.28.09.2021, si dhe në bazë të nenit 22 të Rregullores mbi zgjedhjet në Universitetin e Mitrovicës dhe punën e Këshillit të Fakultetit, në mbledhjen e mbajtur me datë 23.11.2023, në kuadër të kompetencave ligjore, merr këtë:

V E N D I M

I. MIRATOHET Raporti i Komisionit të Ankesave, me nr. prot. 376, dt. 20.11.2023, lidhur me ankesën e paraqitur me nr. prot. 359, dt. 13.11.2023 të parashtrueses Elizabetë Qarri.

II. HIDHET poshtë si e papabazuar ankesa e parashtrueses Elizabetë Qarri, me nr. prot. 359 të datës 13.11.2023, ndaj raportit të Komisionit Vlerësues me nr. prot. 286 të datës 30.10.2023, për konkursin me nr. prot. 2067, dt.10.10.2023, i publikuar në Buletinin nr.4 më 09.11.2023.

III. Raporti i Komisionit Vlerësues, i formuar nga Këshilli i Fakultetit të Edukimit, në përbërje prej: prof. ass. Sarandë Kika – Bahtiri, kryetare, prof. asoc. dr. Besa Luzha, anëtare dhe prof. asoc. dr. Adhurim Rasimi, anëtar, është në harmoni me Ligjin mbi Arsimin e Lartë, 04/L-037, me Statutin e Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë dhe me Rregulloren nr.1670, dt.28.09.2021 për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin "Isa Boletini" në Mitrovicë.

IV. Mbetet në fuqi Raporti i Komisionit Vlerësues me nr. prot. 286, dt. 30.11.2023 dhe i dërgohet për miratim Senatit të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë.

A R S Y E T I M

Më 30.10.2023, Komisioni vlerësues e ka përpiluar raportin vlerësues për pozitën VI/3, "Një mësimdhënës për lëndët: Bazat e edukimit muzikor dhe Interpretim me instrumente".

Sa i përket ankesës së kandidatës Elizabetë Qarri, Komisioni i ankesave e ka verifikuar dosjen e kandidatës sipas kërkesave të konkursit dhe më pas ka konstatuar:

Sa i përket pikës së parë të ankesës, se kryetarja e Komisionit është emëruar në kundërshtim me Rregulloren për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UIBM, konstatohet se Këshilli i Fakultetit e ka formuar komisionin vlerësues sipas pikës 7 të nenit 6 të kësaj Rregulloreje, në të cilën thuhet: “në mungesë të numrit të numrit të mjaftueshëm të profesorëve si në pikën 5 dhe 6 të këtij neni, mund të emërohen edhe profesorë nga departamentet tjera, por në këtë rast kryetari i komisionit duhet të jetë nga radha e profesorëve të departamentit për të cilin janë duke u vlerësuar aplikacionet”.

Andaj, si pikë e lartcekur e ankesës është e pabazuar.

Sa i përket pikës së dytë të ankesës, se “anëtarët e komisionit nuk kanë thirrje në fushën përkatëse...”, Komisioni konstaton se sipas Rregullores për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UIBM, në nenin 12 precizohet se “për çështjet që nuk janë rregulluar me këtë rregullore, me analogji zbatohen dispozitat e Statutit të UIBM-së dhe dispozitat e rregullores për procedurat dhe kriteret e zgjedhjes, rizgjedhjes dhe avancimit të personelit akademik me nr. prot. 1667, dt. 28.9.2021”.

Prandaj për përbërjen e Komisionit, Këshilli i Fakultetit të Edukimit është thirrur në pikën 6 të nenit 10 të Rregullores me nr. prot. 1667, dt. 28.9.2021, e cila specifikon se “në komisione vlerësuese duhet të jenë së paku dy (2) anëtarë nga fusha e ngushtë me lëndët për të cilat është shpallur konkursi”, si dhe e ka respektuar pikën 10 të nenit 16 të Rregullores me nr. prot. 1667, dt. 28.9.2021, e cila specifikon se “anëtarët e komisionit vlerësues mund të jenë edhe nga universitete të tjera në vend dhe jashtë vendit. Në këtë rast, së paku një (1) anëtar i komisionit është i brendshëm-nga Universiteti. Në rastet kur komisioni vlerësues ka dy anëtarë të jashtëm, anëtari i brendshëm me automatizëm është kryetar i komisionit”.

Andaj, si pikë e lartcekur e ankesës është e pabazuar.

Sa i përket pikës së tretë të ankesës, se “anëtari i komisionit z. Adhurim Rasimi në vitin 2023 ka aplikuar si kandidat në lëndën Bazat e Arsimit Muzikor...pra UIBM në të njëjtin vit e ka refuzuar në të gjitha shkallët kandidatin Adhurim Rasimi, duke e konsideruar se nuk i plotëson kushtet për bashkëpunëtorë të jashtëm në lëndën “Bazat e Edukimit Muzikor”...

Komisioni konstaton se nga ankuesja është bërë shtrembërim i fakteve të paraqitura në Raportin e komisionit vlerësues me nr. prot. 42, dt. 13.02.2023 nga FE dhe nr. prot. 440, dt. 20.02.2023 të UIBM-së, pasi që në këtë shkruan në mënyrë specifike: “Adhurim Rasimi, nuk ka përmbushur kriteret e aplikimit sipas konkursit të shpallur në ueb faqen zyrtare të UIBM-së”, ndërsa në procesverbalin e raportit të komisionit për Këshillin e Fakultetit me nr. prot 46, dt.13.02.2023, shkruhet se “aplikuesi Adhurim Rasimi nuk ka aplikuar në formën online, si rrjedhim duke u mbështetur në konkurs ky aplikacion nuk është marrë fare në shqyrtim nga ana e komisionit”.

Andaj, si pikë e lartcekur e ankesës është e pabazuar.

Sa i përket pretendimit të ankueses për përshtatshmërinë e gradës shkencore me pozitat në konkurs, Komisioni konstaton se sipas pikës 2.1 të nenit 7 të Rregullores me nr. prot. 1670, datë 28.9.2021, bashkëpunëtori i jashtëm për ligjërata duhet “të ketë gradën shkencore doktor i shkencave nga lëmia përkatëse. Sipas emërimit në diplomë, ankuesja e ka gradën shkencore “Doktor i shkencave

nga lëmia e dhuntisë dhe talentit”. Ankuesja e ka notën mesatare në bachelor 8.74, kurse në master 7.5.

Kundërkandidatja i ka të regjistruara studimet doktorale në Universitetin e Zagrebit, Akademia e Muzikës, Drejtimi i Muzikologjisë, e ka notën mesatare në studimet bachelor 9.82 dhe 9.85 (dy bachelor), kurse në master 9.85.

Duke u mbështetur në këtë sa u tha më lart, Komisioni i ankesave konstaton se nuk ka kompetencë për ta përcaktuar përshtatshmërinë e gradave shkencore të aplikuesve me pozitat në konkurs.

Prandaj, Këshilli i Fakultetit të Edukimit, pas shqyrtimit të Raportit të Komisionit të Ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Raporti u dërgohet:

Parashtrueses së ankesës
Zyrës për çështje akademike
Arkivës së Fakultetit

Kryesuesja e Këshillit të Fakultetit



Prof.ass.dr. Samira Bllaca - Balaj



UNIVERSITETI I MITROVICËS
"ISA BOLETINI"
FAKULTETI I EDUKIMIT

UNIVERSITETI ISA BOLETINI MITROVICË
FAKULTETI I EDUKIMIT

Pranuar me dt. 20/11/2023			
Njesia organ.	Numer	Nr. Ekzempl.	Vlera
	376		

Nr. Prot. _____ Dt _____

Në bazë të vendimit të Këshillit të Fakultetit të Edukimit me nr. Prot. 254 të datës 20.10.2023 është formuar Komisioni i ankesave për kandidatët të cilët kanë aplikuar në konkursin për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime të personelit akademik në fakultetet e Universitetit "Isa Boletini" të datës 10.10.2023 me Nr. Prot. 2067. Komisioni është mbledhur me datën 20.10.2023 për të shqyrtuar ankesën e Elizabeta Qarri e paraqitur me Nr. Prot. 359 të datës 13.11.2023, pas shqyrtimit të dokumentacionit komisioni i lartëcekur përpiloi këtë:

R A P O R T

- I. REFUZOHET si e pabazuar** Ankesa e parashtruar me Nr. Prot. 359 të datës 13.11.2023 nga kandidatja Elizabeta Qarri.

Arsyetim

Komisioni vlerësues me datë 30.10.2023 ka përpiluar raportin vlerësues për pozitën VI/3 një mësimdhënës për lëndët: Bazat e edukimit muzikor dhe Interpretim me instrumente.

Sa i përket ankesës së kandidatës Elizabeta Qarri komisioni i ankesave ka verifikuar dosjen e kandidatës sipas kërkesave të konkursit dhe më pas ka konstatuar se:

Sa i përket pikës së parë të ankesës se Kryetarja e Komisionit është emëruar në kundërshtim me Rregulloren për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UIBM, konstatohet se Këshilli i fakultetit ka formuar komisionin vlerësues sipas pikës 7 të nenit 6 të kësaj rregullore: "në mungesë të numrit të numrit të mjaftueshëm të profesorëve si në pikën 5 dhe 6 të këtij neni, mund të emërohen edhe profesorë nga departamentet tjera, por në këtë rast kryetari i komisionit duhet të jetë nga radha e profesorëve të departamentit për të cilin janë duke u vlerësuar aplikacionet".

Andaj si pikë e lartëcekur e ankesës është e pabazuar.

Sa i përket pikës së dytë të ankesës se "Anëtarët e komisionit nuk kanë thirrje në fushën përkatëse...", komisioni konstaton se: Sipas Rregullores për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UIBM, precizohet në nenin 12 se "Për çështjet që nuk janë rregulluar me këtë rregullore, me analogji zbatohen dispozitat e Statutit të UIBM-së dhe dispozitat e rregullore për procedurat dhe kriteret e zgjedhjes, rizgjedhjes dhe avancimit të personelit akademik me Nr. Prot. 1667, dt. 28.9.2021".

Prandaj për përbërjen e komisionit, Këshilli i Fakultetit të Edukimit është thirrur në pikën 6 të nenit 10 të rregullores Nr. Prot. 1667, dt. 28.9.2021, e cila specifikon se: “Në komisione vlerësuese duhet të jenë së paku dy (2) anëtarë nga fusha e ngushtë me lëndët për të cilat është shpallu konkursi”; dhe ka respektuar pikën 10 të nenit 16 të rregullores Nr. Prot. 1667, dt. 28.9.2021, e cila specifikon: “Anëtarët e komisionit vlerësues mund të jenë edhe nga universitete të tjera në vend dhe jashtë vendit. Në këtë rast, së paku një (1) anëtar i komisionit është i brendshëm-nga Universiteti. Në rastet kur komisioni vlerësues ka dy anëtarë të jashtëm, anëtari i brendshëm me automatizëm është kryetar i komisionit”.

Andaj si pikë e lartëcekur e ankesës është e pabazuar.

Sa i përket pikës së tretë të ankesës se “Anëtari i komisionit z.Adhurim Rasimi në vitin 2023 ka aplikuar si kandidat në lëndën Bazat e Arsimit Muzikor...pra UIBM në të njëjtin vit e ka refuzuar në të gjitha shkallët kandidatin Adhurim Rasimi, duke e konsideruar se nuk i plotëson kushtet për bashkëpunëtorë të jashtëm në lëndën “Bazat e Edukimit Muzikor”...

Komisioni konstaton se: Nga ankuesja është bërë shtrembërim i fakteve të paraqitura në raportin e komisionit vlerësues me Nr. Prot. 42 dt. 13.02.2023 nga FE dhe Nr. Prot. 440, dt. 20.02.2023 të UIBM-së, pasi që në këtë shkruan në mënyrë specifike se: “Adhurim Rasimi, nuk ka përmbushur kriteret e aplikimit sipas konkursit të shpallur në web faqen zyrtare të UIBM-së, ndërsa në procesverbalin e raportit të komisionit për Këshillin e Fakultetit me Nr. Prot 46, dt.13.02.2023, shkruhet se: “aplikuesi Adhurim Rasimi nuk ka aplikuar në formën online, si rrjedhim duke u mbështetur në konkurs ky aplikacion nuk është marrë fare në shqyrtim nga ana e komisionit.

Andaj si pikë e lartëcekur e ankesës është e pabazuar.

Sa i përket pretendimi të ankueses për përshtatshmërinë e gradës shkencore me pozitat në konkurs.

Komisioni konstaton se: Sipas pikës 2.1 të nenit 7 të rregullores Nr. Prot. 1670, datë 28.9.2021, bashkëpunëtori i jashtëm për ligjërata duhet “të ketë gradën shkencore doktor i shkencave nga lëmia përkatëse”. Sipas emërimit në diplomë, ankuesja ka gradën shkencore “Doktor i shkencave nga lëmia e dhuntisë dhe talentit”. Ankuesja ka notën mesatare në bachelor 8.74, kurse në master 7.5.

Kundërkandidatja ka të rregjistruar studimet doktorale në Universitetin e Zagrebit, Akademia e muzikës, drejtimi i Muzikologjisë. Ka notën mesatare në studimet bachelor 9.82 dhe 9.85 [dy bachelor] kurse në master 9.85.

Duke u mbështetur në këtë sa u tha më lart, komisioni i ankesave konstaton se nuk ka kompetecën për të përcaftuar përshtatshmërinë e gradave shkencore të aplikueseve me pozitat në konkurs.


Komisioni i ankesave i propozon Këshillit të Fakultetit, që të refuzohet si e pa bazuar.

Komisioni:

Prof. dr. Qerim Selimi, Kryetar

Ass. Hatixhe Gashi, Anëtare

Ass. Ylli Hashani, Anëtar

Handwritten signatures in blue ink over horizontal lines. The first signature is a cursive 'Q' followed by 'Selimi'. The second signature is a cursive 'H' followed by 'Gashi'. The third signature is a cursive 'Y' followed by 'Hashani'.

Raporti iu dërgohet:

Arkivës së Fakultetit

Këshillit të Fakultetit

Parashtrueses së ankesës



UNIVERSITETI I MITROVICËS
"ISA BOLETINI"
FAKULTETI I EDUKIMIT

Pranuar me dt. 20/11/2023			
Njesia organ.	Numer	Nr.Ekzempl.	Vlera
	381		

Nr. Prot. _____ Dt _____

Në bazë të vendimit të Këshillit të Fakultetit të Edukimit me nr. Prot. 254 të datës 20.10.2023 është formuar Komisioni i ankesave për kandidatët të cilët kanë aplikuar në konkursin për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime të personelit akademik në fakultetet e Universitetit "Isa Boletini" të datës 10.10.2023 me Nr. Prot. 2067. Komisioni është mbledhur me datën 20.10.2023 për të shqyrtuar ankesën e Elizabeta Qarri e paraqitur me Nr. Prot. 359 të datës 13.11.2023, pas shqyrtimit të dokumentacionit unë si kryetar i Komisionit te lartcekur përpiloi raport :

- I. **Aprovohet si e bazuar** Ankesa me Nr. Prot. 359 të datës 13.11.2023 nga kandidatja Elizabetë Qarri.

Arsyetim

Kandidatja Elizabetë Qarri ka thirrje te doktoratës shkencore, provoj pune ne Universitetin e Prishtinës, në Universitetin e Gjakovës dhe Kolegjin AAB , ka botime shkencore dhe pjesëmarrje ne konferenca shkencore ne fushën e edukimit muzikor.

Unë si kryetar i Komisionit te ankesave i propozon Këshillit të Fakultetit, që të pranoj te bazuar ankesën e kandidates dhe te angazhoj Dr. Sc. Elizabetë Qarri në pozitën si bashkëpunëtorë e jashtme ne mbajtjen e procesit mësimor ne UMIB.

Mitrovicë

20.11.2023

Prof. dr. Qerim Selimi, Kryetar

Raporti iu dërgohet:

Arkivës së Fakultetit

Këshillit të Fakultetit

Parashtrueses së ankesës